REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, mbikëqyrjen e veprimtarive të administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, institucioneve shtetërore dhe të medies në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjen në rrugë administrative të kërkesave ose ankesave që kanë lidhje me procesin zgjedhor;

Vlerëson veprimtarinë e KQZ-së, gjatë vitit 2023, lidhur me:

Angazhimin e KQZ-së gjatë të gjithë procesit, para, gjatë dhe paszgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023; zgjedhjet e përsëritura në Rrogozhinë në datën 23 korrik 2023; zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës në datën 24 shtator 2023;

Publikimin në faqen *web* të KQZ-së: raporte (të monitorimit të fushatës zgjedhore, raportet financiare të partive politike, si dhe raportet e auditimit) për periudhën janar–dhjetor 2023; vendime të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve; vendime të Komisionit Rregullator; udhëzime të Komisionerit Shtetëror; urdhra të Komisionerit Shtetëror; vendime të KSHZ-së; urdhra/vendime të Nënkomisionerit; raporte të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe raporte për KQZ-në;

Zhvillimin e Konferencës "Votimi nga jashtë vendit – rruga përpara!", në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të nxitjes së palëve dhe rritjes së ndërgjegjësimit për mundësimin e votës nga jashtë vendit;

Angazhimin lidhur me shqyrtimin e rezultateve të Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2023, për procesin e dekriminalizimit për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë (2021–2025), për anëtarë në këshillin bashkiak (2023–2027);

Verifikimin e thelluar për kandidatët për zgjedhjet e datës 14 maj 2023;

Angazhimin e KQZ-së, lidhur me zëvendësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve;

Angazhimin në vendimmarrje për plotësimin e vakancave në ushtrimin e funksionit në këshill bashkiak gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024;

Realizimin e fondeve buxhetore në masën 92% për shpenzimet korrente, realizimin në masën 87% për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe realizimin në total të buxhetit në masën 92% të planit të parashikuar për vitin 2023;

Realizimin e implementimit të projektit, në bashkëpunim me qeverinë britanike, për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit rom për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023;

Nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë zvicerane për projektin, i cili synon rritjen e transparencës dhe efektivitetin e KQZ-së nëpërmjet mjeteve digjitale;

Bashkëpunimin e KQZ-së me Këshillin e Evropës për krijimin e Platformës Elektronike të Raportimit Financiar, që synon përmirësimin dhe rritjen e aksesit në informacion, transparencë, rritjen e cilësisë së të dhënave dhe përpunimit të tyre nga përdoruesit e platformës;

Nisjen e dialogut për bashkëpunimin ndërinstitucional me trupat zgjedhore në rajon dhe agjenci të ndryshme në nivel rajonal, për zgjerimin e përdorimit të instrumenteve digjitale në zgjedhje, me mbështetjen e International IDEA dhe Qendrës për Sundimin e Ligjit të Finlandës;

Pjesëmarrjen e KQZ-së gjatë vitit 2023, me ftesë dhe mbështetje financiare të institucioneve homologe, në vëzhgimin e proceseve zgjedhore lokale, parlamentare dhe presidenciale në vendet e rajonit: Estoni, Gjeorgji, Armeni dhe Moldavi;

Pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare në Poloni, Strasburg, Bosnjë-Hercegovinë, Kore e Jugut, Finlandë dhe Gjeorgji.

Kuvendi rekomandon që KQZ-ja, për vitin 2024, të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. T'i kushtojë një vëmendje të veçantë dhe konkrete bashkëpunimit me institucionet përkatëse, përfshirë këtu edhe Kuvendin e Shqipërisë, në vijim të përpjekjeve të ndërmarra gjatë vitit 2022

për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Kodit Zgjedhor për të mundësuar votimin e shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit.

2. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, si dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të sigurojnë një vendimmarrje të drejtë, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme, duke ulur kështu në vijim numrin e padive të cilat kundërshtojnë vendimmarrjet e tyre.

3. Duhet të marrë masa dhe të trajtojë me prioritet çështjen e mosshqyrtimit të plotë nga audituesit e punësuar të të gjitha raporteve vjetore financiare të partive politike, për shkak të adresave të pasakta. Gjithashtu, duhet të parashikojë fluksin real të raporteve që do të shqyrtohen nga audituesit e licencuar, në mënyrë që të mos punësohen më tepër audituesi sesa është e nevojshme, për të evituar kështu dëmin financiar që i shkaktohet fondit të buxhetit të shtetit për financimin e partive politike. KQZ-ja duhet të trajtojë me kujdes procesin e përzgjedhjes së audituesve, duke pasur në fokus qëllimin kryesor që ky proces ka: gjetjet, evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave në përputhje me përcaktimet ligjore.

4. Duhet të angazhohet më tepër në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit për procesin e votimit, në veçanti për votuesit për herë të parë, në mënyrë që të ketë një pjesëmarrje më të lartë të kësaj fashe votuesish.

5. Të marrë masa për garantimin e qëndrueshmërisë së administratës zgjedhore, duke rishikuar sistemin e emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të nivelit të ulët.

6. Të angazhohet më tepër në mundësimin e përdorimit të teknologjisë, në mënyrë që zgjedhësit të votojnë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.

7. Të angazhohet më tepër lidhur me informimin e zgjedhësve në mënyrë të vazhdueshme për format dhe mënyrat se si ata mund të denoncojnë shkeljet, si edhe se si ata mund të mbrohen ndaj pasojave; gjithashtu, në afishimin vazhdimisht të listave të zgjedhësve në të gjitha bashkitë.

8. Të garantojë nëpërmjet administratës zgjedhore aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të kenë akses të pavarur në procesin zgjedhor.

9. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale, në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 4.7.2024.